



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 17.12.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT NR. 10929, DATË 05.11.2018, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR PROPOZIMIN E KRYETARIT TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjet e datave 27.11.2018 dhe 18.12.2018, organizoi seancën dëgjimore dhe seancën për shqyrtimin e kandidaturës së zonjës Vitore Tusha të propozuar nga Presidenti i Republikës si kandidaturë e vetme për postin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me Dekretin nr.10929 date 05.11.2018.

Në seancën e datës 27.11.2018 Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, organizoi seancën dëgjimore me Zonjën Vitore Tusha. Gjatë seancës Zonja Tusha, bëri prezantimin për deputetët.

Në seancën e datës 18.12.2018, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, vijoi procedurën e parlamentare me shqyrtimin e plotësimit të kushteve ligjore të kandidaturës si dhe gjendjen e papajtueshmërisë në funksionin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Komisioni në funksion të shqyrtimit të kandidaturës, administroi:

- raportin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” mbi procesin e ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë” (KPESD), të përcjellë Kuvendit me vendimin nr. 4 datë 16.11.2018 si dhe
- praktikën e depozituar nga Presidenti i Republikës, bashkëlidhur dekretit nr.10929 datë 05.11.2018, “Për Propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”
- praktika të tjera të mëparshme, për të cilat gjatë procedurave të shqyrtimit parlamentar, është bërë analiza e plotësimit ose jo të kritereve formale të kandidaturave për postin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, së pari shqyrtoi Raportin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” mbi procesin e ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e

Drejtësisë”, (KPESD) si dhe procedurën e shortit të organizuar pranë Kuvendit për ngritjet e KEPSD-së për vitin 2019.

Duke ju referuar Raportit të Komisionit të Pavarur dhe procedurave të shortit që çuan në ngritjen e KEPSD-së për vitin 2019, konstatohet se zonja Vitore Tusha, për shkak të detyrës aktuale si anëtare e Gjykatës Kushtetuese, mban edhe funksionin e Zëvendëskryetarit të KPESD-së.

Komisioni i Ekonomisë vlerëson se KPESD midis të tjerave ka një rol vendimtar dhe jashtëzakonisht të rëndësishëm në procesin e ngritjes së organeve të reja të drejtësisë dhe midis të tjerave pritet që me urgjencë të ushtrojë të gjitha kompetencat përfshirë ato lidhur me verifikimin e përmbushjes së kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për:

1. Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe
2. Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

Emërimi i Zonjës Tusha në detyrën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, do të rrezikonte vijimin normal të organit të ri të sapokrijuar, duke vënë në dyshim procese më të rëndësishme sesa ai i zëvendësimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kjo pasi duhet mbajtur në konsideratë:

- gjendja aktuale e KPESD-së me dy anëtarë më pak;
- kushti ligjor, sipas të cilit, përfaqësuesi më i vjetër i zgjedhur nga Gjykata Kushtetuese, është automatikisht Zëvendëskryetar i KPESD (kjo detyrë i ngarkohet automatikisht nga ligji zonjës Vitore Tusha);
- zëvendësimi i saj:
 - o pasi kanë kaluar afatet ligjore,
 - o është ezauruar procedura e hedhjes së shortit dhe
 - o është ngritur KPESD për vitin 2019,

bëhet i pamundur, pasi Kushtetuta dhe Ligji kanë parashikuar që KPESD, (e më pas KED), ngrihet një herë në vit dhe funksionon gjatë një viti, duke u zëvendësuar me një proces stafetë nga njeri vit tek tjetri.

Në lidhje me shqyrtimin e kritererve formale të parashikuara nga neni 20, i ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, konstaton se kandidatura, plotëson kriteret për sa i takon:

- a) arsimimit;
- b) kualifikimeve në fushën e dhënies së drejtësisë dhe përvojë pune në këtë fushë prej më shumë se 10 vjet;
- c) plotëson dhe mund të vlerësohet maksimalisht për integritetin moral dhe profesional në fushën e dhënies së drejtësisë, vlerësim ky i konfirmuar edhe nga procesi i vettingut, të cilin zonja Tusha e ka kaluar prej kohësh;
- d) nuk ka asnjë rast, në të cilin të ketë qenë subjekt i shqyrtimit nga drejtësia dhe aq më pak të jetë dënuar për kryerjen e një veprë penale.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, duke vlerësuar për sa më sipër kandidaturën, konstaton se në gjithë karrierën e zonjës Tusha nuk evidentohet përvojë profesionale në çështje të auditimit sipas kuptimit të termit në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në veçanti atij financiar dhe auditimit të performancës.

Edhe angazhimet e tjera profesionale të zonjës Tusha, janë të fokusuara në lëndë si “E drejtë europiane” apo “Të drejta të njeriut”, të cilat në çdo rast vlerësohen nga Komisioni si shumë të

rëndësishme dhe ndihmojnë në procesin e dhënies së drejtësisë në çdo raport që lind midis shtetasve/subjekteve nga njëra anë dhe sistemit gjyqësor nga ana tjetër.

Por Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, pas arsyetimit si më sipër, evidenton faktin që një eksperiencë e posaçme në legjislacionin financiar dhe auditimin financiar, është e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme nga eksperiencia të tjera, për arsye të specifikës dhe unicitetit të funksioneve që kryen Kontrolli i Lartë i Shtetit. Të gjitha eksperiencat e mëparshme të zonjës Vitore Tusha (përfshirë eksperiencat akademike), janë larg specifikës së çështjeve financiare në përgjithësi dhe auditimit në veçanti si veprimtaritë më të rëndësishme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, (të tilla si “auditimi financiar”, “auditimi i performancës”, “auditimi i përputhshmërisë”, “auditimi i rregullshmërisë dhe ai i IT-së”, etj).

Edhe nga analiza e shqyrtimit të dokumentacionit parlamentar, në raste të mëparshme konstatohet i njëjti vlerësim dhe interpretim i dispozitave të nenit 20, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Kështu gjatë shqyrtimit të Dekretit nr. 7137 datë 27.10.2011, “Për propozimin e zotit Sali Shehu në detyrën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave i ka rekomanduar seancës plenare rrëzimin e dekretit, me arsyetimin se kandidatura nuk kish eksperiencë direkte në fushën e kontrollit financiar dhe ekonomik. Edhe atëherë rasti ishte i ngjashëm dhe profili jurist i kandidaturës u konsiderua si i pamjaftueshëm për të arsyetuar lidhur me kualitetin e kandidaturës në fushën e kontrollit ekonomik dhe financiar, si specifikë e domosdoshme për mirëfunksionimin e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe përmbushjen e objektivave të vendosura nga ligji për këtë institucion.

Në këto kushte në përfundim të shqyrtimit, Komisioni me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje, mbështetur në pikën 7, të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i propozon Kuvendit mosmiratimin e kandidaturës së paraqitur me Dekretin nr.10929, datë 05.11.2018, të Presidentit të Republikës, “Për Propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

KRYETAR

Erjon BRAÇE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit
Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”**

VENDIM

Nr. 4, datë 16.11.2018

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT DREJTUAR KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET
LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT “PËR
PROCESIN E NGRITJES SË KËSHILLIT TË PËRKOHSHËM TË EMËRIMEVE NË
SISTEMIN E DREJTËSISË (KPESD) NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 115/2016 “PËR
ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 12, pika 1 të rregullores “Për organizmin dhe funksionimin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, miratuar me vendimin nr.3, datë 09.11.2018 të Mbledhjes së Anëtarëve të Komisionit të Pavarur,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit drejtuar komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Dejtat e Njeriut “Për procesin e ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë (KPESD) në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ARTAN SPAHIU

KRYETAR

LINDITA RUSMALI

ANËTAR

PETRIT PLLOÇI

ANËTAR

SAIMIR VISHAJ

ANËTAR

IRENA NINO

ANËTAR

R A P O R T

MBI

PROCESIN E NGRITJES SË KËSHILLI I PËRKOHSHEM I EMËRIMEVE NË SISTEMIN E DREJTËSISE (KPESD) NË ZBATIM TË

Ligjit nr. 115/2016
“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, analizoi në një mbledhje të posaçme dispozitat e Kushtetutës dhe ligjit, konstaton sa më poshtë vijon:

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI (KED)

ose

KËSHILLI I PËRKOHSHEM I EMËRIMEVE NË SISTEMIN E DREJTËSISE (KPESD)

Dy herë radhazi (në vitin 2016 dhe 2017), në Kuvendin e Shqipërisë, është njoftuar dhe është zhvilluar procedura e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të njerit prej organave të parashikuara nga 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i cili sipas të gjitha njoftimeve dhe shpalljeve është quajtur “Këshilli i Emërimeve në Drejtësi”.

Rezulton se:

- 1- Këto procedura janë kryer nga Kuvendi i Shqipërisë, pasi Presidenti i Republikës njoftoi pamundësinë e ushtrimit të kompetencës së tij kushtetuese për organizimin e procedurës së shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (b/lidhur shkresa e Presidentit të Republikës);
- 2- Për zhvillimin e kësaj procedure, nëse ju referohemi shkresave dhe komunikimit të kandidaturave që mund të nënshtroheshin shortit, janë zbatuar kushtet dhe procedurat e parashikuara nga neni 284 i Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe për analogji e për aq sa ka qenë e mundur janë referuar dispozitat e parashikuara në Kreun V, neni 217 e vijues i Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Në përfundim të procesit të bërë në vitin 2017, u shpallën emrat e 9 anëtarëve të organit të ngritur për vitin 2018, nga të cilët: 2 anëtarë nga Gjykata Kushtetuese, 1 anëtar nga Gjykata e Lartë, 1 anëtar nga Prokuroria e Përgjithshme, 2 anëtarë nga Zyrat e Prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit, 2 anëtar nga Gjykata e Apelit, 1 anëtar nga Gjykata Administrative.

Siç rezulton nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, deri tani organi i ngritur sipas procedurave dhe i shpallur si më sipër, që do ushtronte veprimtarinë gjatë vitit 2018, ka zhvilluar vetëm një mbledhje konstituimi në datë 19.03.2018 në selinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pranë Gjykatës së Lartë. Në këtë mbledhje organi i ngritur, mori në dorëzim

zyrtarisht dokumentacionin mbi kandidaturat që kanë aplikuar për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese. Në përfundim të mbledhjes së parë, është ngritur edhe një grup pune për hartimin e rregulloreve për funksionimin e tij, dhe ka vijuar puna për rregulloren e cila pret të miratohet gjatë viti 2019.

**KOMISIONI I PAVARUR MORI NE SHQYRTIM
DUKE RIVLERESUAR SA ME POSHTE VIJON:**

Nga analiza dhe shqyrtimi i dispozitave të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe referencat e përdorura për ngritjen e organit të cituar më sipër si KED, rezulton se:

Organi i ngritur, i referuar dëndur si “Këshilli i Emërimeve në Drejtësi” (KED), është në fakt Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë, (që këtu e më poshtë do të referohemi si KPESD), ngritja dhe funksionimi i të cilit parashikohet nga neni 284 i Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Nga analiza e dispozitave që parashikojnë ngritjen e KPESD, mund të arsyetojmë që KPESD është organ ngritja e të cilit:

- bëhet në kushtet kur nuk është ende e mundur të ngrihet KED për shkak se vetë paketa ligjore parashikonte procedura më vëhte për ngritjen e organeve të tjera (KLGJ, KLP, neni 221/3), që duhet të përcillnin kandidaturat për anëtarë të KED;
- konstituohet dhe funksionon si KED dhe
- ushtron të gjitha funksionet e KED deri në përfundimin e vitit kalendarik në të cilin dorëzon stafetën tek KED.

Ndryshimi midis dy organeve dhe që i bëjnë ata të dallueshëm nga njeri-tjetri janë 2:

- Për KPESD futen automatikisht në short të gjithë individët që plotësojnë kriteret, ndërsa Per KED duhet verifikimi i plotësimit të kushteve të bëhet nga KLGJ, KLP;
 - KPESD funksionon edhe në mungesë të KLGJ dhe KLP
- Ndëra ngritja e KED është e varur nga ngritja e KLGJ dhe KLP.

KPESD ashtu si KED pasi të jetë ngritur ushtron të gjitha kompetencat përfshirë atop lidhur me verifikimin e përmbushjes së kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për:

- 1- anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe
- 2- Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

Pasi u analizuar sa më sipër, Komisioni i Pavarur, në vijim i rekomandon Komisionit të Cështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut dhe nëpërmjet tij organeve të ngarkuara nga Kushtetuta dhe Ligji për zbatimin e dispozitave të shqyrtuara nga ky raport, rihapjen e procedurës për hedhjen e shortit për anëtarët e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi për Vitin kalendarik 2019, me këtë arsyetim:

- 1- Dispozitat tranzitore të parashikuara në nenin 284 të Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, kanë në themel të tyre krijimin e një organi i cili do të kryejë funksionet e KED, deri në ditën kur do të krijohen kushtet për ngritjen e KED (që do të thotë që këto dispozita mund të aplikohen një ose disa herë, derisa të shterrojnë qëllimin për të cilin janë hartuar);
- 2- KPESD, krijohet (për analogji me KED) për të funksionuar përgjatë një viti dhe në çdo rast funksionimi është i lidhur me përmbylljen e vitit përkatës, kur organet e tjera të jenë krijuar dhe të bëhet i mundshëm përcjellja e përfaqësuesve në KED.

KPESD pavarësisht datës së fundme në të cilën janë krijuar të gjitha organet e tjera që propozojnë kandidaturat për KED, ushtron veprimtarinë deri në ditën e fundit të atij viti.

- 3- KPESD, ashtu si KED drejtohet nga Anëtari i Gjykatës së Lartë i cili zgjidhet me short nga lista e anëtarëve ekzistues të Gjykatës së Lartë dhe ZëvendësKryetar, anëtarin më të vjetër në moshë të dy kandidaturave të përzgjedhura me short nga lista e anëtarëve ekzistues të Gjykatës Kushtetuese;
- 4- Çdo KPESD e merr në dorëzim punën aty ku e ka lënë KPESD e mëparshme dhe po ashtu ja dorëzon KED.

Nëse i referohemi anëtarëve të Gjykatës së Lartë që janë ende në detyrë, vlerësojmë se shorti që do të hidhet për ta, do të rezultojë në çdo rast i suksesshëm sa kohë që sot janë ende në detyrë më shumë se një anëtar.

Nëse i referohemi anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese që janë ende në detyrë, vlerësojmë se shorti që do të hidhet për ta, do të rezultojë i suksesshëm sa kohë që Gjykata Kushtetuese përfaqësohet në KPESD me dy anëtarë (nga të cilët më i vjetri mban edhe funksionin e Zvendëskryetarit të KPESD) dhe ndërkohë në këtë gjykatë janë ende në detyrë dy anëtarë. Pra aq sa janë të domosdoshëm për kryerjen e shortit.

Arsyetimi se: KPESD, krijohet (për analogji me KED) një herë në vit dhe në çdo rast funksionimi është i lidhur me përmbylljen e vitit përkatës në të cilin organet e tjera që propozojnë anëtarët e KED të jenë krijuar, bëhet duke vlerësuar referencat si më poshtë vijon:

- Neni 284 Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në pikat 1,2,3,4,5 dhe 6 ka parashikuar krijimin e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë;
- Neni 284, në pikën 7, parashikon që KED zgjidhet më pas sipas **nenit 179, pika 11** e Kushtetutës.

Duke analizuar nga njëra anë:

- hyrjen në fuqi të dispozitës së **nenit 179 pika 11** e Kushtetutës (që ka parashikuar ngritjen e KED)

(citim: Presidenti i Republikës, brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zgjedh me short anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi),

dhe nga ana tjetër

- hyrjen në fuqi të **nenin 284 të Ligjit 115/2016** “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (që ka parashikuar ngritjen e KPESD si organ i përkohshëm deri në ngritjen e KED),

vërejmë se:

- dispozita e nenit **179, pika 11** e Kushtetutës ka hyrë në fuqi në datë 11 Gusht 2016;
- dispozitat e nenit **284 të Ligjit 115/2016**, kanë hyrë në fuqi në datë 16 Dhjetor 2016.

Duke qenë se nga interpretimi literal i këtyre dy dispozitave, do të na rezultonte që në ditën që ligji parashikonte ngritjen e KPESD, KED duhet të ishte e krijuar ndërkohë.

Edhe nëse kërkojmë ta interpretojmë më vehte dispozitën Kushtetuese, pra nenin 178, pika 11, që parashikon ngritjen e KED, interpretimi do të na çojë tek i njëjti arsyetim.

- dispozita kushtetuese shprehet: “...Presidenti i Republikës, brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zgjedh me short anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi...” dhe

“...Të zgjedhurit në KED, qëndrojnë në detyrë deri në datën 31 dhjetor të vitit kur hyn në fuqi ky ligj”.

Nga interpretimi literal i dispozitës do të na rezultonte që KED mbyllet një herë e mirë në 31 dhjetor 2016. Por mund të themi me siguri Kushtetuta nuk ka dashur të thotë që KED krijohet, funksionon dhe e perfundon një herë e përgjithmonë funksionin e vet në datë 31 Dhjetor 2016. Nëse do të ish kështu, do duhet të thonim dhe të artikulonim edhe që KED do lindte dhe vdiste pa e kryer asnjëherë funksionin për të cilin do ngrihej.

Na duhet të pranojmë pra, që dispozitat ndjekin një qëllim tjetër dhe për interpretimin e tyre duhet t'i referohemi metodave të tjera të interpretimit që në rastin tonë duhet të jetë interpretimi llogjik. Qëllimi i dispozitës Kushtetuese nuk ka qenë vendosja e datës për fillimin e procedurave për ngritjen e KED, por përcaktimi i afatit një-vjeçar të funksionimit të çdo KED-je.

Kushtetuta na thotë që:

- çdo KED e mbyll funksionin e vet në 31 Dhjetor dhe ndërkohë çdo 1 janar duhet të jenë kryer procedurat për KED-në e rradhës. Ky parashikim në çdo rast duhet interpretuar në funksion të mandatit një vjeçar që Kushtetuta i jep çdo KED-je dhe i gjithë procesi është organizuar si proces stafetë.

Duke konsideruar në bllok të gjitha dispozitat e listuara më sipër mund të arsyetojmë që:

- 1- Ligjvënësi kur ka dashur të dallojë dhe të përshkruajë KPESD dhe KED, me siguri nuk ka dashur që të parashikojë si afat të fundit të funksionimit dhe përmbylljes së misionit të KED në datën 31 Dhjetor 2016;
- 2- Ligjvënësi në dispozitën Kushtetuese (neni 179.11) ka dashur që të përcaktojë si afat për funksionimin e çdo KED-je, afatin një vjeçar, pra: 1 janar – 31 Dhjetor.
- 3- Ky afat mund të fillojë të llogaritet, pra KED mund të ngrihet, vetëm pasi KPESD të jetë ngritur, të ketë funksionuar dhe të ketë plotësuar misionin e vet të përkohshëm. Në çdo rast KED mund të ngrihet për vitin vijues pas vitit në të cilin KPESD arrin të funksionojë normalisht dhe të jenë krijuar organet e tjera që kanë tagrin ligjor për të shqyrtuar plotësimin e kushteve për kandidaturat për anëtarë të KED;
- 4- Për Kushtetutën nuk ka rëndësi emërtimi KED apo KPESD, për shkak se Kushtetuta e ka menduar procesin si proces stafetë, ndaj ngatërrimi i termave nuk mund të shërbejë si justifikim për bllokimin e procesit. I parë si proces stafetë, KPESD nuk e le gjendjen në boshllëk, por pushon së vepruari duke ja dorëzuar stafetën KED;
- 5- KPESD e vitit 2019 praktikisht do e marrë në dorëzim detyrën në fazën e lënë nga KPESD e vitit 2018 dhe do e vijoje gjatë vitit 2019, për ta dorëzuar në vitin 2020. (e kështu me rradhë)

Në këto kushte:

Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” duke konsideruar gjendjen e deri tanishme,

PROPOZON :

Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratëps Publike dhe të Drejtave të Njeriut, të vlerësojë mbajtje në konsiderate të këtij raporti edhe në rast të komunikimit institucional me organet e ngarkuara nga Kushtetuta dhe Ligji për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë për vitin 2019.

Krijimi i Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Siststemin e Drejtësisë, që do të bënte plotësisht të mundur vijimin me sukses të reformës në drejtësi për sa kohë që krijimi i KPESD do t'i jepte udhë midis të tjerave:


- 1- përzgjedhjes së kandidaturave për Gjykatën Kushtetuese dhe
- 2- vijimit të procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të Inspektorit të lartë të Drejtësisë.

ARTAN SPAHIU



KRYETAR

PETRIT PLLOÇI



ANËTAR

SAIMIR VISHAJ




ANËTAR

IRENA NINO



ANËTAR

LINDITA RUSMALI



ANËTAR